



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:063722

Datë: 18.06.2022

Numri i dokumentit: 03147045

P.nr.101/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

DIVIZIONI PENAL Sipas gjyqtarit Shabi Idrizi, me Bahkëpunëtorin profesional, Isuf Bajraliu në çështjen penalo-juridike të akuzuarit A.R nga Ferizaj i akuzuar për shkak të veprave penale Vjedhja e rëndë nga neni 327 par. 1 nën par. 1.1, të KPRK-së, sipas aktakuzave së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.844-1/15 të datës 18.01.2018, PP/II.nr.1920-1/17 të datës 04.04.2018, dhe PP/II.nr.1936-1/17 të datës 04.04.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të dt. 02.06.2022, në prani të përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore-Ferizaj, Zana Sadiku Sertolli, si dhe të akuzuarit A.R, me dt. 06.06..2022 mori dhe shpalli publikisht shpalli , ndërsa me dt. 17 Qershor 2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari A.R nga Ferizaj, rruga.” ... “ i lindur me ... në Luzern-Zvicër, nga i ati F. dhe e ëma F. e vajzërisë A., ashkali, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, i pa martuar, i pa punë, i dënuar më parë, në vuajtje të dënimit.

ËSHTË FAJTOR

I.

Për shkak se,

Me dt. 14.05.2015, rreth orës 20.00, në rrugën, “...” në Ferizaj, përkatësisht lokalit Sallon ondolimi “G...” pronë e të dëmtuarës V.S, në bashkëkryerje me të miturin A.M, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, me përdorimin e forcës kanë hapur derën e lokalit kishin depërtuar brenda dhe kishin marrë 1,000 Euro para të gatshme, parfume të llojeve të ndryshme në vlerë prej 150 euro, duke i shkaktuar dëm në vlerë prej 1,200 euro sipas të dëmtuarës.

- Me të cilën në ka kryer veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 327 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së.

II.

Për shkak se,

Me dt. 23.04.2017, rreth orës 05.30 , në rrugën ;; në Ferizaj, në kafi terinë ë; pronë e të dëmtuarit B.M, i pandehuri me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme vetit të i sjell përftim të kundërligjshëm ashtu që me përdorimin e forcës me një mjet të fort kaçavidë ka hapur derën e lokalit duke depërtuar brenda dhe nga aty ka marrë para të metalta rreth 250 euro dhe një telefon ,, Samsung;; në vlerë prej 150 euro, me çka të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 400 euro.

Me të cilën ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par 1 nën par 1.1 të KPRK-së

III.

Për shkak se ,

Me dt. 22.08.2017 , rreth orës 20.30 , në rrugën ,, në Ferizaj, në lokalit e frizerës “ ...” pronë e të dëmtuarës M.K i pandehuri me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme vetit të sjell përftim pasuror në mënyrë të kundërligjshme, ashtu që me përdorimin forcës me një mjet të fortë kaqavid ka hapur dren e lokalit duke depërtuar mbrenda dhe aty ka marrë një telefon Samsung me çka të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 70 euro.

Me të cilën ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par 1 nën par 1.1 1 të KPRK-së

Prandaj gjykata në kuptim të nenit 76 par 1 të KPRK-së, të akuzuarit;

I C A K T O N

Për veprën penale të kryer me dt. 14.05.2015 të parashikuar nga neni 327 par 1 të KPRK-së , dënimin me burg 1 vit dhe gjobë 100 euro.

Për veprën penale të kryer me dt. 23.04.2017 të parashikuar nga neni 327 par 1 të KPRK-së , dënimin me burg 1 vit dhe gjobë 100.00.

Për veprën penale të kryer me dt. 22.08.2017 të parashikuar nga neni 327 par 1 të KPRK-së, dënimin me burg 10 muaj dhe gjobë 100 euro.

Andaj duke u bazuar në dispozitën e lartcekur ndëshkimore dhe nenin 2, 38,42, 71,72,76 par 2 të KPRK-së dhe nenit dhe 365, 453 dhe 463 të KPPK-së e,

G J Y K O N

Të akuzuarit **A.R** i cakton dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (vjet) e 4 (katër) muaj që do ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi si dhe dënim me gjobë në lartësi prej **300 euro** e cila do paguhet në këste mujore dhe në rast mos pagese do të shndërrohet në dënim me burgim duke e llogaritur çdo 20 euro gjobë 1 ditë burg.

Udhëzohen të dëmtuarit që kërkesën pasuro juridike ta realizojnë në kontest civil

I pandehuri obligohet të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej nga **100,00 €** dhe për fondin e kompensimit të viktimave të dhunës secili nga **30.00 €**,

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore nga Ferizaj, me aktakuzat e saj PP/II.nr.844-1/15 të datës 18.01.2018, PP/II.nr.1920-1/17 të datës 04.04.2018, dhe PP/II.nr.1936-1/17, të datës 04.04.2016, të akuzuarin A.F.R rrg.”...”, Ferizaj e ka akuzuar për shkak të veprave penale të kryera Vjedhja e rëndë nga neni 327 par. 1 nën par 1.1 të KPRK.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze, caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë: 14.10.2020, Prokurori i shtetit ka bërë ri-cilësimin juridik të nenit 327 par.1, në nenin 327 par.1 nënpar.1.1, në këtë shqyrtim, pas konstatimit se i akuzuari është i njëjtë, natyra e veprave penale të njëjta, pas pëlqimit paraprak të palëve dhe për hir të ekonomizimit bazuar në nenin 35 të KPRK ka bërë bashkimin e procedurës penale, ndaj të akuzuarit dhe pas leximit të aktakuzave të lartë cekura nga ana e prokurorit të shtetit, i akuzuari pasi u njoftua për të drejtat

procedurale në kuptim të nenit 246 të KPPK-së, deklararon se pranon fajësinë për veprën penale të kryer me dt. 04.04.2018 sipas aktakuzës PP/II.nr.1936-1/17 të dt. 25.03.2016, datë 22.08.2017 ndërsa nuk e pranoi fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës për veprat penale PP/II.nr.844-1/15 të datës 18.01.2018, e datës 14.05.2015, PP/II.nr.1920-1/17 të datës 04.04.2018 , datë 23.04.2017

Ngase i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për veprat penale të cekura më lartë, në procedurën e provave gjykata bëri dëgjimin e të dëmtuarës- dëshmitaren V.S, dëshmitarit, A.M, i dëmtuari – dëshmitari B.M, bëri leximin e provave materiale

Aktakuza PP.nr.844/2015- Deklarata e të pandehurit në polici e datës 15.05.2015,deklarata e të dëmtuarës me datë.14.05.2015 dhe 18.01.2018, dhe fotografitë në vendin e ngjarjes.

Aktakuza PP/II.nr.1920-1/2017 – Shikohen fotografit nga vendi i ngjarjes. **Aktakuza PP/II.nr.1936/2015**, është bërë pranimi i fajësisë.

Dëshmitarja- e dëmtuara V.S, në deklaratën e saj, të dhënë në hetuesi me datë 14.05.2015, dhe në Prokurori me datë 18.01.2018, duke përsëritur faktin se ishte e vërtetë se me datën13.03.2015, rreth orës 20.00, e kishte mbyllur lokalin në rregull, dhe se të nesërmen rreth orës 08.00 kur punëtorja B.S ka shkuar te lokali, dhe kishte vërejtur se lokali ishte thyer., dhe më ka ftuar, dhe unë menjëherë kam shkuar, dhe kur kemi hyr brenda kemi vërejtur, se disa komoda, kanë qenë të hapura me forcë, dhe aty kam pasur rreth 1,000 si dhe përveç parave, ishin vjedhur dhe kozmetik dhe atë parfuma ”1 milion”, me vlerë 85 euro,”Charli”, 30 euro,”Jordan”, 30 euro, shuma totale 150 euro.

Dëshmitari A.M deklararon: lidhur me rastin kam dhënë deklaratë në Stacionin Policor në Ferizaj me datë 16.05.2015, dhe qëndroj pranë saj. Të akuzuarin A.R e njoh moti kohë me siguri ma shumë se 8 vite me të njëjtin kam pasur raporte të mira shoqërore. Sa i përket rastit në sallonin e ondulimit “G...” pronë e të dëmtuarës V.S, më kujtohet se atë natë, kemi dalë së bashku me të akuzuarin A.në mbrëmje, i njëjti ka pas një shtrafziger, e kemi pa një lokal të frizerkave, më ka thënë ruaj ti, se unë po hy mbrenda, e ka marrë një çante ka kontrollu, mua më ka thënë, se nuk ka pa asgjë prej atyhit, jena nda dhe këna shku nëpër shpija tona, në këtë rast unë kam, përfitu asgjë, unë kam bërë roje, dhe i njëjti më ka thënë se në qantë nuk ka pas asgjë, dera e sallonit ka qenë e mbyllur, vetëm me qelës jo me dry. Ideja ka qenë e A., në vijim deklaroj, se nuk e di, qa ka pas në qante. Përveq këtij rasti këna kryer, edhe vjedhje tjera, Lidhur me rastin me datë 23.04.2017 rr.” ...” në Ferizaj në kafiterinë “...” deklaroj se nuk kam qenë i pranishëm, ndërsa edhe në lokalin sallonin ondulim “...” nuk kam marr pjesë në vjedhje. Në pyetjen sqaruese të gjyqtarit të çështjes se a mund të na vërtetoni, se a është e saktë, deklarimi që e keni thënë në Stacionin Policor në Ferizaj ku keni deklaruar se me datë

14.05.2015 rreth orës 03:00, së bashku me të akuzuarin A.R në një lokal keni vjedh 2 shtëpiza , dhe 2 monitorë, dhe i keni dërgu, në shtëpinë e të akuzuarit, a është e vërtetë, dëshmitari deklaron se është e vërtetë.

I dëmtuari -dëshmitari B.M në deklaratën e dhënë në polici më datë 23.04.2017 prej orës 01:30 deri në ora 05.10 në lokalin “...” ka ndodhur një vjedhje , ku të dyshuari kishin thyer drynin, dhe kishin depërtuar deri te arka, nga kanë marrë monedha të metalta diku rreth 250€dhe një telefon “Samsung S5” me vlerë prej 150€.

I akuzuari në mbrojtjen e tij deklaron: sa i përket rastit në sallonin ondulimit “G...” në rrg.”...”, siç kam deklaruar këtu dhe në polici, nuk kam të bëjë asgjë me këtë rast, deklaroj se, sa i përket rastit të datës 23.04.2017 në rrg.”...” në Ferizaj në kafiterin”...”, ku akuzohem se kam marrë para të imta metalike në vlerë 250€, dhe një telefon Samsung S5 në vlerë 150€, unë deklaroj se nuk kam të bëjë me atë çështje, këtë pranim në Stacionin Policor e kamë bërë, për shkak të dhunës së ushtruar ndaj meje, kurse sa i përket rastit të datës 22.08.2017 në rrugën ”...”, në Ferizaj në lokalin e frizerës ”M...” me kaçavida ka depërtuar brenda, dhe ka marrë një telefon të markës Samsung S5, në vlerë 70€, sa i përket këtij rasti, unë jam gjykuar, dhe e kam pranuar fajësinë.

Prokurori i shtetit Zana Sadiku Sertolli në fjalën e vet përfundimtare deklaron se: Konform nenit 352 dhe 353 të KPK-ës në çështjen penale sipas aktakuzave PP.nr.844-1/15 e dt.18.01.2018 dhe PP/II.nr.1920-1/17, të dt.04.04.2018, PP.II.nr.1936/17 e dt.04.04.2018 të ngritura kundër të pandehurit A.R për shkak të dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 327 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-ës. Me qenëse në çështjen penale PP.II.nr.1936-1/17 në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë me datë 14.10.2018, atëherë fjalën përfundimtare e vazhdoj për lëndët me PP.nr.844-1/15 e dt.18.01.2018 dhe PP/II.nr.1920-1/17, pasi i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë. Gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës PP.II.844-1/15 nga deklarata e të dëmtuarës V.S vërtetua që është pronare e sallonit ondulimit ”G...” si dhe nuk e njeh të akuzuarin A.R, sipas vlerësimit të saj, dëmi shkaktuar ishte rreth 1,000€para të gatshme, që kanë qenë në çantën e saj. Si dhe 3 parfuma të firmës “1 milion” në vlerë prej 85€, parfumi ”Charli” në vlerë prej 30€dhe parfumi “Jordan” në vlerë prej 30€.

Nga dëshmia e dëshmitarit A.M të dhënë në shqyrtimin e sotëm gjyqësor, u dëshmuua ndërsa, ishte me të miturin, në bashkëveprim me të pandehurin A.R pas marrëveshjes paraprake kishin shkuar në sallonin e ondolimit ”G...” me një mjet të fortë kaçavide hap me forcë derën e mbyllur me qelës, ku kishte marrë një çante. Ngase dëshmitari A.M , sipas dëshmisë së tij, nuk e di se çka ka pasur në atë çantë, pasi që kishte bërë roje, dhe nuk ka hyrë mbrenda në

lokal. Ndërsa A.R e mohon se ka kryer veprën penale që e ngarkon aktakuza, edhe pse në deklaratën e dhënë në Stacionin Policor me dt.15.05.2015 e ka pranuar në tërësi këtë e dëshmon edhe dëshmitari A.M këtë mohim e bënë për ti shmangur përgjegjësisë penale.

Ndërsa sa i përket rastit PP.II.nr.1920-1/2017 gjendja faktike vërtetohet nga deklaratat e të dëmtuarit – dëshmitarit B.M është pronar i kafiterisë ”...” ka dëshmuar se lokali i ka pasur dy hyrje, dhe të njëjtat kanë qenë të mbyllura me çelës, dhe sipas dëshmisë së tij. Nga hyrja e dytë kanë hyrë, kanë depërtuar me forcë, persona të panjohur, dhe kanë arrite ti marrin, nga sirtari para të metalta rreth 250€, një telefon Samsung S5 vlerë 150€,sipas vlerësimit të dëmtuarit vlera është 400€.

Edhe në këtë çështje penale i akuzuari e mohon kryerjen e veprës penale, edhe pse në deklaratën e dhënë në Stacionin e Policisë të nënshkruar nga ai vetë me dt.07.09.2017, e ka pranuar në tërësi, ndërsa në Prokurori me dt.22.02.2018, është mbrojtur në heshtje. Andaj duke pasur parasysh të gjitha provat e administruara, dhe elaboruara, ti shqiptoj një dënim meritor për të tri rastet penale, ngase pamëdyshje janë vërtetuar veprimet inkriminuese se i akuzuarit është kryerës i këtyre veprave penale që i vihen në barrë. Andaj në rast se gjykata e gjenë fajtor si rrethanë rënduese ta marrë personalitetin e të akuzuarit se është recidivist i shumëfishtë i veprave penale të ë njëjtës natyrë kundër pasurisë së luajtshme vepra është kryer me dashje , ndërsa si rrethanë lehtësuese prokurori i shtetit nuk qeti.

I pandehuri në fjalën përfundimtare deklaron: Kërkoj nga Gjykata të më liroj nga aktakuza, ngase konsideroj se nuk kam kryer këto vepra penale, ngase për veprat penale që jam akuzuar, jam i dënuar, jam në vuajtje të dënimit deri në vitin 2027.

Gjykata shqyrtoi dhe vlerësoi me kujdes deklarimin e dëshmitarit-dëmtuarit V.S dhe vëren se e njëjta ka një vazhdimësi logjike është identike me deklaratat e dhëna në polici, dhe se deklarimit të tillë i fali besimin. Edhe nga dëshmia e dëshmitarit A.M në mënyrë konsistente, nga përshkrimin, dhe mënyra se si e kanë kryer veprën penale, u vërtetua se me deklaratën e dhënë në Stacionin Policor, dt.15.05.2015 e ka pranuar në tërësi veprën penale, prandaj mohimi i kryerjes së veprës penale , është shmangia nga përgjegjësia penale, gjykata gjendjen faktike, dhe besueshmërinë e vërtetoi, me këtë deklaram. Është provuar, gjendja faktike edhe me deklaratën e të dëmtuarit B.M, të dhënë në Stacionin e Policisë se me datë 07.09.2017, e ka pranuar i akuzuari në tërësi, se e ka kryer veprën penale në lokalin e të dëmtuarit, gjykata e konsideron të besueshme.

Gjykata morri në shqyrtim mbrojtjen e të akuzuarit i cila nuk mohon faktin se me dt. 16.05.2015 kishte kryer veprën penale ashtu siç është e përshkruar në diapozitivin I të

aktgjykimit, ndërsa për dy veprat tjera penale deklaroi se nuk i kujtohen dhe se nuk i ka kryer këto vepra penale dhe një deklarami i tillë bie ndesh me deklaramet tija. këto raste në polici, por edhe nga gjetjet në vendngjarje dhe dëshmime, fotografive, deklaramit të tillë gjykata nuk i fali besimin ngase atë nuk e argumentoi me asnjë provë të vetme, dhe se nuk arriti ta venë në dyshim provat e ofruara nga prokuroria, porse me tepër ishte tentim për t'iu shmangur apo zbutur përgjegjësisë penale .

Gjykata ka bere vlerësimin e provave te shqyrtuara një nga një dhe te gjitha së bashku dhe ka konstatuar këtë gjendje faktike;- Me dt. 14.05.2015, rreth orës 20.00 , në rrugën , “...” në Ferizaj, përkatësisht lokalit Sallon ondulimi “G...” pronë e të dëmtuarës V.S, në bashkëkryerje me të miturin A.M, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, me përdorimin e forcës kanë hapur derën e lokalit kishin depërtuar brenda dhe kishin marrë 1,000 Euro para të gatshme, parfume të llojeve të ndryshme në vlerë prej 150 euro, duke i shkaktuar dëm në vlerë prej 1,200 euro sipas të dëmtuarës.

Me dt. 23.04.2017, rreth orës 05.30 , në rrugën ;; në Ferizaj, në kafiterinë “...” pronë e të dëmtuarit B.M, i pandehuri me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme vetit të i sjell përfitim të kundërligjshëm ashtu që me përdorimin e forcës me një mjet të fortë kaçavidë ka hapur derën e lokalit duke depërtuar brenda dhe nga aty ka marrë para të metalta rreth 250 euro dhe një telefon , Samsung;; në vlerë prej 150 euro, me çka të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 400 euro.

Me dt. 22.08.2017 , rreth orës 20.30 , në rrugën , 12 Qershori, në Ferizaj, në lokalit e frizerës “M...” pronë e të dëmtuarës M.K i pandehuri me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme vetit të sjell përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme, ashtu që me përdorimin e forcës me një mjet të fortë kaçavidë ka hapur derën e lokalit duke depërtuar mbrenda dhe aty ka marrë një telefon Samsung me çka të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 70 euro, gjykata vlerëson se gjendja faktike, është vërtetuar plotësisht dhe drejtë.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhje rëndë nga neni 327 par 1 nën par 1.1, të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 72,73 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese faktin se i akuzuari është i gjendjes së dobët ekonomike, koha e kaluar nga kryerja e këtyre veprave penale dhe mos përsëritja e veprimeve të tilla dhe pranimin e pjesshëm të fajësisë , ndërsa në rastin konkret rrethanë rënduese vlerësoi se i akuzuari gjendet në vuajtje, dhe është recidivist për vepra të

natyrës së njëjtë, shkallën e përgjegjesisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, vlerën e cenuar (prona private) përsëritjen e veprimit të njëjtë.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventive gjeneral).

Udhëzohen të dëmtuarit që kërkesën pasuro juridike ta realizojnë në kontest civil

I pandehuri obligohet të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej nga 100,00 € dhe për fondin e kompensimit të viktimave të dhunës secili nga 30.00 €,

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2018:063722, 06.06.2022

G j y q t a r i

Shabi Idrizi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.

Numri i lëndës: 2018:063722
Datë: 18.06.2022
Numri i dokumentit: 03147045